



Raporti Vjetor



2020

Fjalë hyrëse

Për të arritur vizionin tonë drejt një shoqërie demokratike, e cila është e aftë dhe e gatshme të drejtojë një shtet funksional, të integruar në rajon dhe në bashkësinë ndërkombëtare, Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) punën e drejton në tri programe bazë: Qeverisje Demokratike, Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Bashkëpunim Rajonal. Nga këto programe, tri të parat janë baza e aktivitetin tonë, kurse program i tretë është komplementar ndaj dy të parave dhe na shërben për shkëmbimin e përvojave dhe ndërtimin e sinergjive.

Kur flas për punën e bërë gjatë vitit 2020, e kam të pamundur të mos e përmend se që prej themelimit të INDEP në vitin 2011, ky vit që po lëmë pas ka qenë një nga vitet më sfiduese për ne. Duke qenë se ne në INDEP si ekip planifikojmë agjendën e zbatimit të aktiviteteve një vit më herët, pandemia COVID na ka gjetur të papërgatitur. Në afate shumë të shkurta kohore, instituti ynë është dashur të adaptohet me format e reja të punës të cilat na janë imponuar si formë mbrojtje ndaj përhapjes së pandemisë COVID-19.

Pavarësisht kësaj pengese të paparishikuar, e konfirmoj me krenari se INDEP-i ka arritur të zbatojë të gjitha aktivitetet e parapara për këtë vit, duke u përshtatur me forma inovative, duke i inkorporuar platformat elektronike në aktivitetet tona dhe duke kombinuar forma të ndryshme implementimi dhe interaktiviteti për të arritur qëllimin tonë final – suksesin në aktivitete.

E konsideroj të rëndësishme të përmbledh punën tonë si më poshtë. Hulumtimet e pavarura kanë qenë pjesë kryesore e punës sonë edhe në 2020, duke publikuar 27 të tilla. Në Qeverisje Demokratike, përkatësisht pjesëmarrjen aktive në konsultime publike, kemi dërguar komentet tonë në 5 konsulta të hapur, me theks kontributin tonë në Agjendën Evropiane të Reformave dhe avokimin e vazhdueshëm që kemi bërë për Amandamentimin e Ligjit aktual për Mbrojtjen e Konsumatorit. Kemi zhvilluar 4 fushata të zëshme në rrjete sociale: Miqtë e Energjisë, Ambientalistin, Mbrojtësit e Konsumatorëve, Promovimi i Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ) në Kosovë. Në Zhvillim të Qëndrueshëm vlerësoj se kemi arritur impakt të dukshëm në promovimin e dy aspekteve kyçe të programit: promovimin e eficiencës së energjisë dhe promovimin e OZhQ-ve.

Parë zhvillimet në botë, Kosova më nuk mund të tolerojë zhvillim ekonomik i cili nuk merr për bazë mjedisin. Prandaj, kujdesemi që në të gjitha drejtimet e aktivititet tonë të avancojmë agjendën tonë bazuar në parimet e demokracisë dhe vlerave demokratike, ngrejmë zërin për çështje shoqërore dhe politike, por duke pasur në mendje principet e mbrojtjes së mjedisit.

Për më shumë, ju ftoj të shfletoni raportin tonë për vitin 2020.

Sinqerisht,

Burim EJUPI,

Drejtor Ekzekutiv i INDEP.

Tabela e Përmbajtjes

3	5	6	10
Fjalë hyrëse	Tabela e Përmbajtjes	Programet e INDEP	INDEP-i gjatë 2020
12	13	15	16
Qeverisja Demokratike	Konsultimet Publike	Reagimet	Monitorimet
17	23	25	26
Mbrojtja e Konsumatorit	Barazia Gjinore	Zhvillimi i Qëndrueshëm	Java e Zhvillimit të Qëndrueshëm
28	29	30	31
Miqtë e Energjisë	Ambientalisti.info	OZHQ (17); Agjenda 2030.	Publikimet
37	47	50	51
Punëtoritë / Tryezat	Bashkëpunimi Rajonal	INDEP në Medie	Donatorët

Programet e INDEP

Qeverisja Demokratike



Në programin e Qeverisjes Demokratike hulumtimi i politikave kombinohet me avokim të vendosur duke u fokusuar në parti politike funksionale, sigurimin e zgjedhjeve të pavarura e të drejta, fuqizimin sundimin të ligjit dhe përparimin e lirisë së mediave.

Zhvillimi i Qëndrueshëm



Programi i Zhvillimit të Qëndrueshëm e bën INDEP institutin e parë në rajon që promovon zhvillim ekonomik i cili avancohet kushtet shoqërore dhe politike duke mbrojtur ambientin. Ky program fokusohet në projektet ekonomike dhe energjetike në Kosovë e rajon.

Bashkëpunimi Rajonal



Bashkëpunimi Rajonal është një parakusht për rrugën e vendeve të Ballkanit perëndimor për në Bashkimin Europian. INDEP synon që të promovojë dhe forcojë këtë bashkëpunim në fushat e sigurisë dhe integriteteve Euro Atlantike.



Programi i Qeverisjes Demokratike në INDEP zhvillohet përmes bashkëpunimit me akterët vendimmarrës të sistemit legjislativ në Kosovë. INDEP përqendrohet në proceset të cilat çojnë tutje demokracinë dhe vlerat që demokracia i ngërthen përmes punës së ngushtë me Kuvendin e Kosovës, duke qenë zë i pavarur në trajtimin e çështjeve legjislative dhe të politikave. Ne në INDEP kemi qëllim që jo vetëm të sigurohemi se ligjet dhe politikat në Kosovë përputhen saktë me nevojat e qytetarëve dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian por që edhe të jemi forcë e cila thërret për forcimin e rolit mbikëqyrës të Parlamentit ndaj institucioneve të pavarura dhe agjencive të cilat funksionojnë me ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Përmes kontributit të punës sonë të paanshme, INDEP konsideron se jemi akter i cili ndihmon në vënien e parimeve të demokracisë në vend, e cila tutje sjell zhvillim ekonomik, siguri, zgjedhje të lira dhe të ndershme, sundim ligji dhe liri të medieve.



Programi i dytë i INDEP, Zhvillimi i Qëndrueshëm, është program ku INDEP promovon zhvillimin ekonomik që përfshin zhvillim social dhe politik të vendit duke ruajtur mjedisin. Programi ka si fokus të ardhmen e ekonomisë dhe energjisë në Kosovë dhe rajon. Ky program është programi pionier i INDEP për Kosovë dhe program i cili e ka bërë akter të njohur ndërkombëtarisht INDEP-in. INDEP-i nis vazhdimisht debate që adresojnë sfidat e zhvillimit të Kosovës dhe angazhohemi aktivisht rreth politikave energjetike të Kosovës. Përmes kapaciteteve kërkimore dhe shtrirëse, INDEP është i pozicionuar mirë për të punuar në lidhje me çështjet e politikave zhvillimore dhe për të avokuar për politikëbërje dhe zbatim më të mirë me të gjithë aktorët në dispozicion.

INDEP beson se rregullimi i sektorit të energjisë duke integruar eficiencën e energjisë, burimeve të ripërtëritshme në sektor dhe orientimit të vendit në projekte 'eco-friendly' shtron rrugën e vetme të zhvillimit të qëndrueshëm në nivel vendi.



Programi i tretë, Bashkëpunimi Rajonal, synon përfshirjen integrale të Kosovë në proceset rajonale. Duke bashkëpunuar me entite rajonale dhe evropiane, si organizatat joqeveritare, agjencitë, institucionet dhe nismat, INDEP garanton që puna që bën në Kosovë është e përditësuar dhe rekomandimet tona përputhen me zhvillimet në vendet tjera. Këtë program e zhvillojmë përmes përfaqësimit në konferenca ndërkombëtare, diskutimeve të ndërsjella me partner rajonalë dhe evropiane dhe përmes përdorimit të metodave krahasuese të hulumtimeve në publikimet tona.

Kosova mund të arrijë të jetë partner i barabartë dhe anëtarë e organizatave ndërkombëtare vetëm duke ndjekur hapin e zhvillimit të tyre. Vlen të ceket bashkëpunimi që e kemi me projektin e GIZ për SDG në Evropën Juglindore: Rasti i Kosovës, si dhe me shtet tjera fqinje që kemi bashkëpunuar më herët.

INDEP-i gjatë 2020

Edhe në vitin 2020 INDEP ka vazhduar përpjekjet e tij për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm për të gjithë dhe për të promovuar një shoqëri më të drejtë, më gjithëpërfshirëse dhe më të integruar. 2020-a shënoi vitin e 9-të të punës së INDEP-it, ku për këtë vit Qeverisja Demokratike dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm kanë përbërë shtyllën kryesore të aktiviteteve të INDEP. Kjo, për faktin që pandemia e cila ka zgjatur gjatë tërë vitit 2020 na ka imponuar që puna jonë në programin tonë të tretë, Bashkëpunimin Rajonal, të zhvillohet me intensitet më të ulët.

Me pandeminë në tremujorëshin e parë të vitit, INDEP i ka anuluar të gjitha aktivitetet deri me 27 Mars. INDEP ka përdorur forma inovative për tu adaptuar ndaj masave të reja shtrënguese. Duke filluar nga data 7 Maj, INDEP ka rifilluar punën fizikisht në përputhje me masat e Qeverisë për distancim fizik dhe pajisjet mbrojtëse për stafin. INDEP të gjitha aktivitetet e planifikuara i ka shtyer deri në hapjen e pjeshme të radhës.

Më pastaj, aktivitetet e INDEP prej periudhës mars deri në përfundim të vitit, janë mbajtur të mbyllura për publikun por me transmetim virtual në faqet e INDEP dhe platformave tona të projekteve. Kjo ka rezultuar metodë shumë efektive pasi INDEP ka arritur të ketë më shumë se 90 mijë shikime të kombinuara në të gjitha transmetimet tona virtuale të tryezave, konferencave dhe ngjarjeve.

Përkundër vështirësive me pandeminë, INDEP-i ia ka dalë të implementojë me sukses 15 projekte. Si produkte të këtyre projekteve, në vitin 2020 kemi publikuar 27 hulumtimeve, 9 në fushën e Qeverisjes Demokratike dhe 18 punime të tjera në Zhvillimin e Qëndrueshëm.

Kemi mbajtur 30 tryeza dhe punëtori me akterë relevantë vendimmarrës, organizata joqeveritare dhe qytetarë e aktivistë. Në 6 konsultime publike kemi dërguar komentet tona bazuar në hulumtime, në të cilat kemi dhënë rekomandime konkrete.

Aktiviteti ynë vetëdijësues është zhvilluar kryesisht përmes metodave virtuale, ku kemi implementuar 4 fushata të ndryshme në rrjete sociale me më shumë se 150 infografika dhe materiale vetëdijësuese, të cilat kanë qenë jashtëzakonisht të suksesshme.

Shtuar tyre, kemi lansuar edhe dy platforma: 'Ambientalisti.info' dhe Mbrojtësit e Konsumatorëve'.

Gjithashtu, kemi publikuar 12 video informuese. Të gjitha këto, gjenden në faqen zyrtare të INDEP @InstitutiINDEP në Facebook, në @Indepofficial në Instagram dhe www.indep.info.

INDEP 2020



27
Publikime



30

Tryeza / Punëtori / Konferenca

15
Projekte

6

Kontribute në Konsultime
Publike



4
Fushata
Vetëdijësuese

5
Konferenca për
Medie



12
Video Informuese



150
Infografika



1.7 milion

'Reach' në rrjete sociale



2
Platforma



8
Pjesëmarrje në Konferenca
Ndërkombëtare



10
Donatorë

Qeverisja Demokratike

Përmes programit për Qeverisje Demokratike, INDEP kombinon punën e pavarur hulumtuese me punën avokuese. Synimi i këtij program është stabilizimi i institucioneve të përgjegjshme të cilat zhvillojnë procese që promovojnë zhvillim të përgjithshëm më të theksuar. Fusha e veprimtarive përfshin, megjithatë nuk është e kufizuar në forcimin e sundimit të ligjit, avancimin e lirisë së medias dhe ndihmën në demokratizimin e partive politike. Veprimtaria jonë është kanalizuar në avokim të vazhdueshëm, publikim të punimeve, komente në konsultime publike, takime virtuale me akterë vendimmarrës, fushata në rrjete sociale dhe publikim të materialeve informuese, si video, infografika dhe broshura.

- Avokim i vazhdueshëm

INDEP-i si pjesë e avokimit për qeverisje demokratike gjatë vitit 2020 është takuar me Kryeministrin, z. Avdullah Hoti, Ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, z. Vesel Krasniqi, Kryetarin e Komisioni për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri dhe Investime Strategjike, z. Endrit Shala, deputetë të shumtë e udhëheqës të institucioneve vendimmarrëse të nivelit lokal dhe qendror. Në këto takime, INDEP ka avokuar dhe këshilluar për hapat ligjor që duhet të merren varësisht nga proceset, si dhe për veprimet e mëtejme që duhet të merren nga këto entitete në mënyrë që përfitimet për qytetarë dhe mbarëvajtja e institucioneve vendore të jetë maksimale, si dhe që përparimi të ndihet e reflektohet në jetën e përditshme të tyre.

- Publikimet e pavarura

INDEP pjesë kryesore të punës i ka hulumtimet e pavarura. Bazuar në faktin që INDEP punën hulumtuese kryen i pandikuar nga faktorë të jashtëm, ka bërë që publikimet tona të jenë të besueshme dhe të merren parasysh nga vendimmarrësit. Që prej fillimit të punës sonë, INDEP nv baza vjetore publikon rreth 20 hulumtime. Këtë vit, nga 27 gjithsej, 9 hulumtime kanë qenë në fushën e qeverisjes demokratike. Publikimet tona përpos që janë të qasshme për publikun edhe në formë fizike edhe elektronike, ato iu dërgohen politikanëve, deputetëve dhe përfaqësuesve tjerë të agjencive dhe institucioneve vendore por edhe ndërkombëtare. Për këtë qëllim, pothuajse të gjitha publikimet tona janë të qasshme edhe në anglisht, në indep.info.

Konsultimet Publike

Që nga viti 2012, INDEP monitoron punën e disa prej komisioneve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Konsultimet publike të hapura për publikun shënojnë një nga format më të mira të kontributit të INDEP. Gjatë tërë vitit, INDEP monitoron konsultimet e hapura dhe dërgon komente. Për vitin 2020, INDEP ka dërguar komente në 6 konsultime publike. Deri më tani, INDEP me shumë sukses ka arritur që nëpërmjet rekomandimeve konkrete të dalë nga hulumtimet e shumta, pjesëmarrjes aktive në proceset e konsultimeve publike dhe platformave të tjera, të jenë pjesë e draftimit të akteve normative të ndryshme. Krahas kësaj, me anë të angazhimit të vazhdueshëm, INDEP tashmë zotëron një bashkëpunim të mirëfilltë me institucionet qendrore siç është Kuvendi i Kosovës. Si më të rëndësishmet, më poshtë renditen disa.

1. **Agjenda Evropiane e Reformave** - Si dokument u është shpërndarë palëve e ndarë në tre dokumente të ndryshme sipas shtyllave të ndryshme dhe palëve u është kërkuar që komentet eventuale për secilin nga këto tre dokumente t'i dërgojnë tek zyrtarë të ndryshëm publik. Kjo ka mundur të shkaktoj një vështirësi për organizatat që kanë dashur të komentojnë në dokumente të ndryshme dhe nuk i kanë pasur të gjitha të integruara në një vend. Gjithashtu, vërehen ndryshime në gjuhën e dokumenteve nga njëra tek tjetra çka e rritë vështirësinë për hartimin e këtyre dokumenteve. Dokumentet nuk janë shoqëruar me një dokument konsultimi që do të përshkruante në detaje procesin e hartimit, përzgjedhjen e prioritetve dhe se cilat janë sfidat dhe problemet që ERA 2 do të adresoj, cilat do të jenë prioritetet, indikatorët dhe si do të vijoj procesi i matjes së impaktit të tyre. Për procesin e konsultimit publik, dokumenti i konsultimit i shërben rritjes së gjithëpërfshirjes pasi e bënë më të lehtë për organizata me më pak kapacitete që gjithashtu të përfshihen në procesin e konsultimit. Ani pse në fazë të hershme, konsiderojmë që dokumenteve do të duhej t'u shoqërohej një dokument apo memorandum i tillë. Sidoqoftë, në përgjithësi dokumenti i Agjendës Evropiane të Reformave është një bazë e mirë për një progres të gjithëmbarshtëm në fushën e integritit evropian. Përgjatë viteve, INDEP ka përcjellur legjislacionin dhe politikën në një gamë të gjerë të fushave që mbulojnë zhvillimin e qëndrueshëm. Për këtë, komentet për ERA 2 janë rezultat i punës hulumtuese të Institutit në një sërë të këtyre fushave dhe si pjesë e programeve të organizatës për zhvillim të qëndrueshëm, qeverisje demokratike dhe bashkëpunim rajonal. Në pjesën e qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit ne konsiderojmë që ndonëse drafti i ERA 2 ka sjellë një bazë të mirë të rrugës që duhet ndjekur përpara, ka nevojë për përfshirje të disa elementeve shtesë të cilat janë të rëndësishme sidomos për procesin e reformës në administratë publike. Në pjesën e sigurimit të infrastrukturës së cilësisë, ne konsiderojmë që nevojitet të fuqizohen dispozita rreth standardeve dhe krijimit të kushteve për promovim më të madh të tyre. Në energji, reformimi i skemave mbështetëse për burimet e ripërtrishme të energjisë ka qenë kërkesë e kornizës së re të politikave të Bashkimit Evropian për vite tashmë. Vendet e rajonit veçse e kanë filluar këtë proces. Për këtë INDEP konsideron që korniza kohore e propozuar në ERA 2 është jashtëzakonisht e vonë dhe se nevojitet që të lëvizet shumë më shpejt drejtë aplikimit të sistemit të ankandëve për burime të ripërtrishme të energjisë.

Për vendosjen e ankandëve, është e domosdoshme krijimi i një baze ligjore të qartë në këtë fushë. Pastaj ndjekja e një dinamike të domosdoshme për Kosovën dhe në fund, zbatimi i skemës duke marrë parasysh përvojën që vendet e rajonit tashmë e kanë krijuar në këtë fushë.

2. Hartimi i Projekt Udhëzimit Administrativ Për Mbikëqyrjen Metrologjike – INDEP ka marrë pjesë në konsultimin publik të hapur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë respektivisht, Agjencia e Metrologjisë së Kosovës në cilësinë e Organit Propozues për hartimin e Projekt Udhëzimit Administrativ Për Mbikëqyrjen Metrologjike, ka dërguar 9 komente gjithsej, 6 prej të cilave janë pranuar plotësisht dhe tash janë të inkuorpuara në këtë Projekt Udhëzim Administrativ. Tani që në Programin Legjislativ të Qeverisë ka hyrë Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L- 132 për Automjete, kemi ripostuar Analizën e INDEP për Ligjin për Automjete.

3. Konsultimi Publik për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Inspektoratin e Tregut – Marrë në tërësi, INDEP konsideron që nga aspekti teknik, Rregullorja është hartuar drejt dhe përmbush pritjet e parashtruara në Dokumentin e Konsultimit. Megjithatë, Dokumenti i Konsultimit, nuk jep një shpjgim të mjaftueshëm se cilat janë problemet aktuale në zbatim të legjislacionit dhe cilat janë pritjet që kjo Rregullore e re pritët t'i adresoj. Nuk ka ndonjë parameter numerik se sa, psh., është numri i inspektimeve që pritët të rritet si rrjedhojë e miratimit të kësaj Rregulloreje apo se cilat do të jenë pritjet për sukses në të ardhmen.

1. MMPH dhe Komuna e Prishtinës të mos shndërrohen në Institucione për Degradim Mjedisor
2. Me 31 Janar 2020, INDEP së bashku me organizata partnere nga shoqëria civile në mbështetje të Grupi për mbrojtjen e Liqenit të Badovcit dorëzuan kallëzimin penal për ndertimet e planifikuara të Liqeni i Badovcit.
3. Bankat të zgjerojnë planet për pezullimin e pagesave të kredive, ndërsa Qeveria të ndihmojë qytetarët në nevojë
4. Marrëveshja e Gjellbër për Ballkanin – Mundësi e artë për ndryshimin e domosdoshëm
5. INDEP MIRËPRET TËRHEQJEN E CONTOUR GLOBAL NGA NDËRTIMI I TERMOCENTRALIT ‘KOSOVA E RE’
6. QEVERIA TË HARTOJË PLAN EMERGJENT PËR PËRBALLIMIN E PASOJAVE EKONOMIKE TË COVID-19
7. Rimëkëmbja e ndërmarrjeve publike kërkon borde profesionale, të pavarura dhe që reflektojnë diversitetin shoqëror”

Reagimet

Monitorimet

CEE Bankwatch Network ndihmuar nga Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) ka monitoruar zonën përreth 2 termocentraleve, Kosova A dhe Kosova B përgjatë një muaji, nga 7 shkurti 2020 deri më 3 Mars 2020. Të dhënat nga ky monitorim tregojnë se ndotja nga Termocentralet Kosova A dhe B i tejkalojnë në shumë ditë vlerat kufi të lejuara të ndotjes. Specifikisht, niveli i ndotjes i lejuar për PM10 është tejkaluar në 17 nga 26 ditët e monitoruara, ndërsa ndotja kufi e lejuar për PM2.5 është tejkaluar në 23 nga 26 ditët e monitoruara. Këto nivele janë jashtëzakonisht të rrezikshme sepse efektet e tyre në ambientin përreth dhe popullsinë e Obiliqit, por edhe më gjerë, shkaktajnë dëme tejet serioze si në shëndet, si në jetën e gjallë.

Ky monitorim gjithashtu ka gjetur se emetimet nga majat afatshkurtra të ndotjes dhe sidomos asaj që vjen nga Kosova A janë shumë më të lartë gjatë natës pas perëndimit të diellit ose rreth mesnates, për arsye të panjohura. Potencialisht, kjo ndotje mund të vijë nga ndalja e filtrave gjatë natës me qëllim rritjen e prodhimit të energjisë.

Mbrojtja e Konsumatorit

“Mbrojtësit e Konsumatorëve” shënon fushatën më të madhë që INDEP ka ndërmarrë deri më tash. Fushata është lansuar në korrik të vitit 2020 dhe vetëm deri në dhjetor 2020 ka mbledhur 12 mijë ndjekës. Me qëllim të vetëdijësimit të qytetarëve për të drejtat e konsumatorit, raportimit të rasteve të shkeljeve dhe rritjen e përgjegjësisë së bizneseve dhe institucioneve për sigurinë dhe kualitetin e produkteve dhe shërbimeve në Kosovë, INDEP ka hapur edhe profilin në Instagram @mbrojtësitekonsumatoreve. Platforma ka postuar 45 poste dhe infografika gjatë 2020-ës, me më shumë se 2,500 pëlqime, 150 komente direkte drejtuar platformës, 500,000 ‘engagements’ dhe 330 ‘reach’. Deri më tani, kjo fushatë është fushata më e madhe e implementuar në vend për mbrojtjen e konsumatorit, por gjithashtu edhe prej më të mëdhajave e zhvilluar ndonjëherë në Kosovë.

Fushata është brenda programit për Qeverisje Demokratike, ku INDEP-i e ka të inkuorporuar në strategjinë e vet mbrojtjen e konsumatorit edhe për të paktën 4 vitet e ardhshme. Instituti ynë po punon fuqishëm që mbrojtja e konsumatorit të shndërrohet në një nga prioritetet e institucioneve vendimmarrëse. Përveç një nga kushtet për anëtarësim në BE dhe organa tjera ndërkombëtare, mbrojtja e konsumatorit është fushë shumë e rëndësishme në jetën e qytetarëve dhe na prek çdo ditë.

Pandemia COVID-19 na ka provuar edhe që vendi ynë jo që nuk e ka prioritet mbrojtjen e konsumatorit, por edhe se legjislacioni në vend është i mangët. Konsumatorët gjatë pandemisë janë dëmtuar shumë dhe reformat në legjislacionin aktual për mbrojtjen e konsumatorit janë kërkesë e kohës digjitale që po e jetojmë. Tregu i vendit ka nevojë emergjente për trupa që i kontrollojnë rreptësisht standardet dhe në të cilin konsumatorët janë të mbrojtur e të sigurtë. Përafrimi i legjislacionit me acquis-in e BE-së pos që avancoon mbrojtjen e konsumatorit në vend, na hap rrugën për integrim gjithashtu.



Education



Awareness raising



Reporting

+100

DIRECT SUPPORT OF CONSUMERS THROUGH FB AND IG MESSAGES

+8.2k

FACEBOOK PAGE LIKES



Mbrojtësit e Konsumatorëve
Kosovo Consumer Watchdog

#qelisyhtë

+500

PAGE FOLLOWERS

+2.6k

POST LIKES, COMMENTS, SHARES AND MENTIONS

+45

TOTAL POSTS

+35

INFOGRAPHICS

ALL POSTS WERE ADAPTED IN DIFFERENT SOCIAL MEDIA FORMATS

+326k

PEOPLE REACHED

+117

INSTAGRAM STORIES

3 ONLINE EVENTS

7 PUBLICATIONS

2 REPORTS


Mbrojtja e konsumatorëve në Kosovë: Standardet, rregullat dhe politikat

**Në fushën e mbrojtjes së
konsumatorit, gjatë vitit
2020 INDEP-i ka
publikuar 7 Hulumtime
dhe 2 Raporte.**




1. **"Analizë e zbatimit të Ligjit nr. 06 / L-034 për mbrojtjen e konsumatorit"**; Ky punim i shërben identifikimit të fushave ku zbatimi ende çalon dhe për të parë nëse ka nevojë për një proces të amendamentimit të Ligjit apo jo. Për më tepër, kjo analizë synon të rrisë dialogun në mes të palëve në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve në funksion të përmirësimit të praktikave të zbatimit të Ligjit, shkëmbimit të përvojave dhe rritjes së vetëdijësimit në përgjithësi. Qëllimi i punimit është që të jetë një pikë referuese shtesë për grupet punuese në të ardhmen që do të merren me ndryshimin dhe plotësimin e bazës ligjore.

2. **"Mbrojtja e konsumatorëve në Kosovë: Standardet, rregullat dhe politikat"**; Kosova ka bërë disa përmirësime në drejtim të rregullimit të bazës ligjore, politikave dhe rregulloreve për të mbështetur mbrojtjen e klientit dhe të drejtat e tyre. Sidoqoftë, siç tregon raporti i progresit për Kosovën 2020, Kosova është ende në një fazë të hershme kur krahasohet me standardet e BE-së. Ekziston ende nevoja për të harmonizuar Ligjin për Mbrojtjen e Konsumatorëve me legjislacionin evropian (acquis të BE-së).



3. **"Praktika e mbrojtjes së konsumatorëve nga ana e Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale"**; Në kuadër të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, funksionon gjithashtu edhe Komisioni për Ankesa, i cili Komision merret me shqyrtimin e ankesave dhe kërkesave nga palët e ndryshme që i janë drejtuar KPMM-së. Numri i përgjithshëm i ankesave gjatë vitit 2019, ka qenë 53 ankesa, numër ky, dukshëm më i vogël se ai i vitit të kaluar që ishte gjithsej 78 ankesa dhe që mund të vlerësohet si tipar pozitiv i punës së bërë nga KPMM gjatë vitit. Për shkak se Komisioni trajton kryesisht ankesa ndaj vendimeve të Bordit, do të ishte shumë më e dobishme sikur ky institucion të ishte një departament i veçantë brenda KPMM-së. Kjo do të ruante pavarësinë e Departamentit dhe vendimet për ankesat do të ishin më kualitative.




4. **"Monitorimi i zbatimit të Pakos së Energjisë së Kosovës (Energjia, Energjia Elektrike dhe Ligji për ZRRE-në) dhe Mbrojtja e Konsumatorit"**; Fusha legjislative dhe e politikave të energjisë përfshin një gamë të gjerë çështjesh si furnizimi me energji, infrastruktura, tregu i brendshëm i energjisë, konsumatorët, energjia e ripëtritshme, eficientia e energjisë, energjia bërthamore dhe siguria, dhe mbrojtja nga rrezatimi. Megjithatë, ky punim përqendrohet në çështjet që prekin konsumatorët, dhe më vonë në këtë punim do të shihni se deri më sot kanë mbetur shumë sfida për të zbatuar plotësisht kornizën ekzistuese të legjislacionit në sektorin e energjisë që ndikon në mbrojtjen e konsumatorit.

5. **"Vendosja e mbrojtjes së konsumatorëve të karburanteve në kontekst: Politikë sektoriale me efekte të shumëfishta ekonomike për konsumatorët"**; Ky punim do të paraqesë kornizën ekzistuese institucionale dhe legjislative në Kosovë për të drejtat e konsumatorëve të karburanteve, si dhe sfidat që i pengojnë konsumatorët e karburanteve të Kosovës të kërkojnë të drejtat e tyre ekonomike të garantuara me ligj. Tutje, punimi vazhdon me paraqitjen e rasteve të suksesshme të SHBA, BE dhe Japoni në garantimin e të drejtave të konsumatorëve të karburanteve. Çdo seksion ofron karakteristikat kryesore të praktikave të mbrojtjes së konsumatorëve të karburantëve dhe ndikimin që ka pasur zbatimi i rregullave të karburanteve në avancimin e interesave ekonomike të konsumatorëve. Në fund, punimi ofron një listë të rekomandimeve me hapa konkret për t'u përfshirë në ligjet e Kosovës nga politikëbërësit.





6. **"Adresimi i nevojës për ngritjen e kapaciteteve në institucione publike me fokus ngritjen e burimeve njerëzore në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorit"**; Ky punim diskuton zhvillimet e fundit dhe sfidat e vazhdueshme të kapaciteteve administrative në institucionet publike dhe kërkesat dhe hapat e ardhshëm për të ecur më shpejt në procesin drejt anëtarësimit në BE. Kjo përfshin miratimin dhe zbatimin e Parimeve të Administratës Publike në fushën e ndërtimit të kapaciteteve njerëzore të cilat u zhvilluan nga SIGMA në 2014. Këto parime janë një pjesë integrale e procesit të Zgjerimit të BE-së.





7. **"Praktika e mbrojtjes së konsumatorëve nga ana e Zyrës së Rregullatorit për Energji"**; Në Matriksën për Vlerësimin e performancës në trajtimin e ankesave, ZRRE ka marrë 52 pikë nga 100 gjithsej. Numri i madh i ankesave që ZRRE pranon dhe mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore dhe administrative kanë bërë që një numër i tyre të barten nga viti në vit. Për më tepër, ZRRE ende nuk ka ndërtuar një memorie institucionale të brendshme mbi ankesat që do t'u mundësonte atyre të kategorizojnë ankesat në mënyrë më të drejtë, të nxjerrin statistika domethënëse dhe të bëjnë ndryshime të atilla që u përgjigjen ankesave dhe rrisin efikasitetin e shërbimeve në sektorin e energjisë.

8. **Raport: "Energy Regulatory Office: The role of ERO in consumer protection in the field of energy"**; (I qasshëm vetëm në anglisht). Ky punim ofron instruksione dhe jep informata se si procedohen ankesat në ZRRE dhe cilat praktika ndiqen.



9. **Raport: "Consumer Protection: The Legal and Institutional Framework from the Perspective of the Consumer Protection Department"**; (I qasshëm vetëm në anglisht). Ngjashëm sikur raporti i mësipërm, edhe ky raport është i karakterit informues se si Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit i trajton ankesat nga konsumatorët.

Barazia Gjinore

Barazia gjinore ka hyrë si domen i ri i punës së INDEP tri vite më parë. INDEP ka vlerësuar se as qeverisja demokratike as zhvillimi i qëndrueshëm nuk mund të arrihet pa arritur fillimisht barazi gjinore, përkatësisht përfaqësim të barabartë gjinor. Avokimin mbi barazi gjinore, INDEP gjatë vitit e ka zhvilluar përmes implementimit të aktiviteteve të ndryshme. Aktivitetet kryesore gjatë 2020-ës kanë qenë:

- **Aktivitete dhe loja stimuluese për barazi gjinore me nxënësit e shkollave të ndryshme në komuna të ndryshme të Kosovës, aktivitetet me fëmijët të cilët janë në edukimin e mesëm të ulët.**




- **‘Shkollën Kosovare për Vajzat që Synojnë Shërbimin Civil’**

Për herë të parë në Kosovë, INDEP mbajti ‘Shkollën Kosovare për Vajzat që Synojnë Shërbimin Civil’, i vetëm i këtij lloji në vendin tonë. Me qëllim që të promovojë barazinë gjinore, përparësitë e angazhimit të barabartë të grave dhe burrave në jetën publike dhe proceset vendimmarrëse, si dhe fuqizimin e vajzave të reja në përgjithësi, përgjatë 3 muaj, kjo shkollë mblodhi 15 vajza të reja që synojnë një karrierë profesionale në të ardhmen e tyre në sektorin publik.

Shkolla solli para tyre figura të shumta të rëndësishme që kanë dhënë kontribut të pamasë në institucionet e nivelit lokal dhe qendror të Kosovës, dhe njëkohësisht shërbyen si shembuj që nuk duhet hequr dorë nga realizimi i ëndrrës së tyre.

- **SDG BRUNCH - Fuqizimi i grave dhe vajzave përmes shkencës dhe teknologjisë**
 Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) bashkë me Ekipin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNKT) dhe UN Women Kosovo kanë mbajtur eventin e 6-të dhe të fundit, të edicionit SDG Brunch, në vitin 2020. Në këtë event u diskutua rreth nevojës për përfshirje më të madhe të grave në shkencë dhe teknologji. Përpos fjalëve të rastit që u dhanë nga shefja e zyrës së UN Women Kosovo dhe drejtorit ekzekutiv të INDEP, u prezantuan edhe dy storje suksesi të grave dhe vajzave të përfshira në sektorin e shkencës dhe teknologjisë. Mysafire nderi e këtij eventi ishte kryetarja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani, e cila premtoi mbështetjen dhe përkushtimin e saj për gratë dhe vajzat që ndjekin studimet në STEM në këtë mandat që ajo sapo ka nisur.



- Punimin me titull **“Ligji për barazinë gjinore në Kosovë: Analiza e përmbytjes, vlerësimi i zbatimit dhe hapat e ardhshëm”**

Kjo analizë e mbështetur në qasjen e barazisë përmbytëse synon të jap një pasqyrë të përbushjes së obligimeve shtetërore të mishëruara në Ligjin për Barazi Gjinore (LBGj) për të promovuar, garantuar dhe mbrojtur barazinë gjinore si një ndër parimet themelore të shtetit kosovar. Analiza fillimisht jep një historik të shkurtër të situatës së grave në Kosovë dhe zhvillimeve legislative në këtë aspekt. Më pas ajo është e ndarë në katër pjesë kryesore sipas kapitujve të LBGj-së: dispozitat e përgjithshme, mekanizmat institucionalë për barazi gjinore, mbrojtja dhe trajtimi i barabartë në bazë të përkatësisë gjinore në marrëdhëniet e punës, trajtimi i barabartë dhe mbrojtja nga diskriminimi në baza gjinore në fushën e arsimit, sanksionet dhe dispozitat përfundimtare. Secili kapitull analizohet veç e veç në kontekst të barazisë përmbytëse, përmbytjes tekstuale dhe zbatimit. Në fund analiza përcjellet me dy propozime rekomanduese lidhur me (mos)zbatimin e LBGj-së.

Zhvillimi i Qëndrueshëm

Programi i Zhvillimit të Qëndrueshëm brenda INDEP-it përfshin shtytjen para të zhvillimit ekonomik duke i respektuar parimet e mbrojtjes së mjedisit dhe duke i mbrojtur vlerat themelore shoqërore për jetë të dinjitetshme. Në këtë kontekst, energjia është sektori kryesor i këtij programi. INDEP vlerëson së viti 2020 e ka vënë Kosovën në një udhëkryq energjetik. Me anulimin e kontratës për ndërtimin e termocentralit 'Kosova e Re', Kosova ka fitur mundësi që sektori të drejtohet në projekte eco-friendly dhe të cilat garantojnë një të ardhme më të gjelbër për vendin. INDEP përmes këtij program punon në avancimin së gjelbër energjetike, qoftë përmes publikimit të hulumtimeve të pavarura me shifra dhe rekomandime konkrete se si të arrihet kjo, avokimit të klasa politike dhe vendimmarrësë dhe qoftë përmes fushatave vetëdijësuese që targetojnë qytetarët e thjeshtë, bizneset dhe sektorin privat.

Investimet në efikasitet të energjisë dhe energji nga burimet e ripërtëritshme në anën tjetër, arrihet siguria energjetike për qytetarët, duke ruajtur shëndetin dhe mjedisin tonë, por edhe avancohet pozita e Kosovës në rrugën e integritit.

Ne në INDEP, besojmë që shoqëria civile është jo vetëm një kritikues konstruktiv dhe monitorues i përpiktë i punës së institucioneve, por edhe një partner në punë e iniciativa të mira. Për këtë, Instituti që unë drejtoj ka mbështetur punën e Grupit për Hartimin e Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë. Ky Plan është një ndërmarrje tejet e rëndësishme që do të përcaktoj kornizat e politikëbërjes në sektorin e energjisë dhe më gjerë së paku deri në vitin 2030 dhe me projeksion deri në vitin 2050. Prandaj, tani është mundësia për Kosovën që të tregoj përkushtim dhe të shpallë një datë të largimit të qymyrit nga sistemi i vet energjetik.

Ne po ashtu shpresojmë që ju do të hapni perspektivën për investime në burime të ripërtrishme të energjisë duke ndërtuar një sistem konkurrues dhe fer. Funkcionalizimi i energjisë së ripërtëritshme është domosdoshmëri për vendin, filluar nga eliminimi i burokracisë së stërgjatur e deri te prezantimi i modeleve dhe skemave dedikuara burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

- Kallëzim penal: INDEP së bashku me organizata partnere nga shoqëria civile në mbështetje të Grupit për mbrojtjen e Liqenit të Badovcit, dorëzuan sot kallëzimin penal për ndërtimet e planifikuara të Liqenit të Badovcit.

Java e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Për të tretin vit me radhë, INDEP është partner bashkëorganizativ i Javës së Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë, edicioni i sivjetëm i Javës së Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë kthehet me një platformë krejtësisht të re virtuale, panele të shumta diskutimi dhe evente paralele, ku është diskutuar ekskluzivisht rreth rimëkëmbjes së gjelbër ekonomike nga pandemia COVID-19 me përfaqësues të institucioneve qendrore, organizatave ndërkombëtare dhe shoqërisë civile.

Si aktivitet specifik, INDEP në kuadër të Javës së Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kosovë (KSDW), dhe në bashkëpunim me BGF kanë mbajtur panelin diskutues mbi eficiencën e energjisë në Kosovë. Ky panel diskutues u mbajt përfaqësues të nivelit qendror, si Agjencisë së Kosovës për Eficiencë të Energjisë dhe Fondit së Kosovës për Eficiencë të Energjisë, dhe nivelit komunal, Komunës së Klinës. Në këtë ngjarje, përpos diskutimit INDEP dhe BGF kanë publikuar edhe punimet e tyre respektive mbi gjendjen aktuale dhe praktikat mbi skemat obligative të eficiencës së energjisë, fuqizimi i rolit të Fondit, si dhe ngritja e standardeve të eficiencës së energjisë në prokurimin publik në nivel komunal.



From today's panel discussion:

Energy Efficiency: Current Stance and Future Plans for Kosovo



Miqtë e Energjisë

Për Ditën Ndërkombëtare të Efiçencës së Energjisë, Instituti për Politika Zhvillimore shenon fushatën e parë të vitit 2020 të implementuar nga INDEP 'Miqtë e Energjisë'. Kjo fushatë ka nisur në muajin mars dhe ka zgjatur deri në muajin qershor. Në numra, kjo fushatë ka arritur më shumë se 1 milionë 'post impressions' që shënon shifrën më të lartë të arritur në ndonjë fushatë të zhvilluar nga Instituti INDEP por edhe institucionet e tjera ndonjëherë në Kosovë. Fushata ka postuar 23 infografika, 2 video, marketing në vende të frekuentuara dhe në media si tradicionale, ashtu edhe online, si dhe promovim të EE përmes prezencës në TV kombëtare. Qëllimi i kësaj fushate ka qenë mbështetja e Kosovës drejt zbatimit më të hovshëm të masave të efiçencës së energjisë dhe arritjen e synimeve sipas Planit të Veprimit për efiçencën e energjisë. Kjo fushatë është vazhdimësi e angazhimit të INDEP për promovimin e efiçencës së energjisë. Miqtë e Energjisë ka paur synim informimin dhe nxitjen e publikut dhe bizneseve rreth përdorimit të energjisë efiçente. Miqtë e Energjisë e ka arritur misionin pasi EE tashmë po promovohet edhe si aset i objekteve dhe është shndërruar në kriter, e jo opsjon.

Ambientalisti.info

Në kuadër të programit për Zhvillim të Qëndrueshëm, INDEP-i ka lansuar platformën www.ambientalisti.info. Kjo platformë është e para e këtij lloji në Kosovë, e cila në një vend të vetëm i ka mbledhur lajmet, raportet dhe materialet e fushës së mjedisit, ka prezantuar kalendarin ekologjik me të gjitha ngjarjet që shënohen në vend për mjedis nga 64 organizata joqeveritare që janë pjesë e kësaj platforme, si dhe që përmban edhe kalkulatorin e parë të emetimeve të karbonit. Platforma ka shpërndarë 60 infografika, ka mbledhur 65 anëtarë të OSHC-ve, ka arritur një 'reach' prej 250 mijë njerëzve, si dhe në vazhdimësi rrit numrin e grupit. Kjo çon në një bashkëpunim dhe azhurnim më të mirë të punës që OSHC-të në Kosovë po bëjnë në mjedis si fushë tematike. Ambientalisti.info shërben edhe për të informuar qytetarët mbi punën e institucioneve publike në këtë drejtim, si dhe mobilizimin dhe promovimin e organizatave joqeveritare të profilizuara në këtë fushë.



Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (17); Agjenda 2030.

17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Agjenda 2030 janë në qendër të punës së INDEP për të tretin vit me radhë. Përpos që INDEP mban portfolion e OZhQ-ve dhe Agjendës 2030 si organizata lidere për Kosovë, angazhimi ynë zgjatet edhe në punën me vetëdijësim. Në këtë drejtim, fushata për rritjen e vetëdijes për rëndësinë e OZhQ-ve në Kosovë ka nisur në gjysmën e dytë të vitit 2020 për të vazhduar deri në gjysmë të vitit 2021. Deri në 2021, fushata ka postuar 3 infografika të cilat kanë shtruar terrenin për një punë më intensive gjatë 2021-ës.

Publikimet

1. Avancimi i Bashkëpunimit të Komuniteteve Afariste të Serbisë dhe Kosovës

Ky raport ka paraqitur sfidat themelore të cilat pengojnë normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës, si dhe rastet dhe mundësitë që mund të vlerësohen përmes bashkëpunimit më të fortë të komuniteteve të biznesit dhe marrjes në konsideratë të iniciativave rajonale, si një kornizë e mundshme për inkurajimin e procesit të normalizimit. Shqyrtohet konteksti më i gjerë socio-ekonomik në të cilin realizohet bashkëpunimi i njerëzve dhe komuniteteve afariste, me një fokus të veçantë në procesin e avancimit të normalizimit të marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës i cili po kryhet nën përkujdesjen e BE-së (Dialogu i Brukselit), procesit të integritit të Serbisë dhe Kosovës në BE dhe mundësive të cilat i ofrojnë iniciativat rajonale. Në këtë dritë, Dialogu i Brukselit dhe iniciativat rajonale shërbejnë si një kornizë shpjeguese në të cilën shihet efektiviteti i masave të ndryshme që kanë reflektime të rëndësishme në të tashmen politike dhe ekonomike të këtyre ekonomive.

2. Analizë: Reflektimi i Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm në Programin e Qeverisë 2020-2030

Ky punim analizon nivelin e reflektimit të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm (OZhQ) në Programin e Qeverisë 2020 – 2023. Kjo analizë përfshinë vlerësimin e gatishmërisë së Programit të Qeverisë për reflektimin e OZhQ-ve dhe ndërlidhjet midis tyre në nivel vendi. Vlen të theksohet se kjo analizë bëhet për herë të parë në këtë format. Kjo analizë mund të përdoret si hap i parë në përcaktimin e integritit dhe zbatimit të OZhQ-ve. Pjesa kryesore paraqet analizën për nivelin e reflektimit të OZhQ-ve dhe se cilat objektiva të Programit të Qeverisë kontribuojnë drejt arritjes së 17 objektivave dhe 169 qëllimeve (targets) relevante për Kosovën.

3. Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë - Praktika dhe mjetet më të mira për një rol transformues

Punimi paraqet një histori të shkurtër të Eficiencës së Energjisë, pastaj përcakton më në detaje statusin, strukturën dhe funksionimin e FKEE, karakterizon ofruesit e tij kryesorë dhe diskuton se ku dhe si burimet koncesionare janë më të nevojshme për t'i adresuar boshllëqet e investimeve të EE në sektorët prioritar. Tutje, punimi përqendrohet në rolin transformues të FKEE dhe konsideron rëndësinë e tij në përmbushjen e qasësive të EE në Kosovë, kursimet e ardhshme të energjisë, dhe marrëdhëniet e tyre me kompanitë e energjisë. Gjatë gjithë procesit të këtij hulumtimi, disa kufizime janë hasur në hapa të ndryshëm të shkrimit, nga mbledhja e të dhënave e deri te analizimi i të dhënave. Sidoqoftë, për shkak të pandemisë botërore të sëmundjes koronavirus (COVID-19) kufizimi kryesor ishte mbajtja e intervistave me hisedarët kryesor, veçanërisht nga FKEE dhe AKEE.

4. Gjendja aktuale dhe praktikat e mira për implementimin e skemave obligative për eficiencën e energjisë dhe masat alternative

Ky dokument shërben si kornizë për drejtimin e diskutimit se si duhet të prezantohet dhe dizajnohet një skemë efektive obligative për eficiencë të energjisë (OEE) dhe masat tjera alternative. Ai përfshin përshkrimin e kontekstit të Kosovës në lidhje me OEE-në, shtjellimin e veçorive kryesore të OEE-ve, duke dhënë përkufizime, shpjegime të fushëveprimit dhe rëndësisë, si dhe opsione për t'u marrë në konsideratë.

5. Akterët dhe hartimi i politikave për zbatimin efektiv të Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë të Kosovës

Ky punim synon të krijojë një hartim gjithëpërfshirës të akterëve dhe politikave përkatëse të nevojshme për tu futur në zbatim me sukses të NECP. Punimi do të synojë të identifikojë mekanizmat aktualë të vendosur, pjesën e përgjegjësisë për secilin sektor dhe fushat në të cilat bashkëpunimi është më i nevojshëm.

6. Ulja e TVSH-së për investimet në energji solare fotovoltaike dhe prodhimin e decentralizuar

Ky studim fokusohet në analizën dhe opsionet për stimulimin e instalimit të sistemeve fotovoltaike në nivel të amvisërive. Rekomandimet stimuluese shënjestrojnë institucionet e Republikës së Kosovës, kryesisht të përqendruara në Qeverinë e Kosovës dhe agjencitë përkatëse, si dhe Kuvendin e Kosovës. Stimulimi i sistemeve fotovoltaike të bazuara në vetë-konsum varet nga një numër i faktorëve jashtë konsideratave tipike të kapacitetit gjenerues. Tregu potencial për instalimin e FV-ve të nivelit të amvisërive në Kosovë është një funksion kompleks i modeleve të konsumit të energjisë, kostos së energjisë, të hyrave të amvisërive, kostos së instalimeve të FV-ve, sistemeve stimuluese (përfshirë disponueshmërinë e kredisë) dhe vetëdijesimit në lidhje me kapacitetin diellor. Këta faktorë kryesorë, të kombinuar me një numër të konsideratave të tjera specifike më të vogla, tregojnë gjasat që amvisëri të përvetësojnë sisteme FV, si dhe shkallën e përvetësimit.

7. Përfitimi nga eficientia e energjisë nga sektori rezidencial

Fokusi i këtij dokumenti është të propozojë një politikë, përmes së cilës më shumë resurse publike alokohen tek transformimi i sektorit të energjisë, duke hyrë në sektorin e banimit. Këto masa do të stimulonin sektorin e ndërtimitarisë, pasi ndryshe ndikimi ekonomik i pandemisë do ta godiste fort, me efekt të fortë në pjesën tjetër të ekonomisë. Ligji aktual për eficiencën e energjisë i mundëson FKEE-së të hartojë, së bashku me qeverinë, një mundësi të re financimi për sektorë të tjerë, përveç objekteve publike. Mundësia e tillë e re duhet të fillojë duke shfrytëzuar financimin nga shteti në sektorin e banimit.

8. **Analizë e zbatimit të Ligjt Nr. 06 / L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorit**

Ky punim është hartuar në kuadër të komponentës së mbrojtjes së konsumatorit në kuadër të programit të INDEP për qeverisje demokratike. Mbrojtja e konsumatorit, në kuadër të programit të INDEP për qeverisje demokratike mbështetet nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Pikëpamjet, përfundimet dhe rekomandimet e shprehura në këtë analizë janë të INDEP dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të donatorit.

9. **Analizë e Raportit Vjetor të Komisionit për Miniera dhe Minerale për vitin 2019**

Raporti i KPMM-së është ndër më të kompletuarit sa i përket përshtatjes me Manualin për Raportim të Agjencive dhe Institucioneve të Pavarura. Në përvojën e INDEP, Raporti i KPMM-së ofron një pasqyrë të mjaftueshme të sektorit, të veprimtarisë së Komisionit dhe të sfidave të sektorit. KPMM shkon edhe një hap më tutje, dhe duke prezantuar sfidat dhe vështirësitë në realizimin e misionit të saj, ofron edhe rekomandime se si të zgjidhen ato. Ne vlerësojmë që një qasje e tillë proaktive e KPMM-së, mund të jetë ndihmuese për politikëbërësit dhe është një shembull i mirë që duhet ndjekur edhe nga Rregullatorët e tjerë.

10. **Agjenda 2030 në Kosovë: Zhvillimi Ekonomik, Çështjet Sociale, Infrastruktura, Inovacioni, Mjedisi, Qeverisja dhe Bashkëpunimi**

Ky punim është bazuar në kornizën globale të treguesve dhe ka përdorur të dhëna zyrtare për monitorimin e progresit mbi objektivat dhe treguesit. Ky punim nxjerrë në pah nivelin e monitorimit dhe zbatimit të OZhQ-ve në Kosovë duke përfshirë sfidat për sigurimin e të dhënave cilësore dhe të përditësuara. Pjesa kryesore paraqet progresin që Kosova ka bërë drejt arritjes së OZhQ-ve sipas treguesve në 5 fusha, konkretisht në atë të zhvillimit ekonomik (OZhQ 1, 2, 8, 12), çështjet sociale (OZhQ 3, 4, 5, 10), zhvillimi i infrastrukturës dhe inovacioni (OZhQ 6, 7, 9, 11), çështjet e mjedisit (OZhQ 13, 14, 15) dhe qeverisja dhe bashkëpunimi (OZhQ 16 dhe 17). Kjo pjesë paraqet një pasqyrë statistikore me të dhënat e fundit për treguesit e OZhQve në Kosovë (për disa vite mungojnë të dhënat).

11. **Analizë e Raportit Vjetor të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit**

Në këtë analizë janë paraqitur edhe të gjetura të tjera të cilat janë të mangëta për nga sqarimi i hollësishëm i tyre. Duke filluar nga rritja e sasisë së ujit të humbur e duke vazhduar me sqarimet rreth investimeve kapitale të cilat janë mjaft konfuze. Këto pjesë raporti nuk i sqaron sa duhet. Përmes këtij raporti vërehen dallime të mëdha tek pagesat e shërbimeve të ujërve mes konsumatorëve të Mitrovicës së Veriut dhe konsumatorëve të pjesëve tjera të Kosovës. Këto dallime në çmime janë mjaft diskriminuese sa i përket pagesave ndaj këtyre konsumatorëve. Kjo çështje paraqet një problem mjaft të lartë i cili duhet të zgjidhet.

12. **Analizë e Raportit Vjetor të Agjencisë së Hekurudhave të Kosovës (AHR) për vitin 2019**

Instituti për Politika Zhvillimore në kuadër të punës mbështetëse për Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, ka shqyrtuar dhe analizuar raportin vjetor të AAC për vitin raportues 2019. Kjo analizë përkon me preokupimin e vazhdueshëm të INDEP me çështjen e agjencive të pavarura dhe instrumenteve mbikëqyrëse së punës së tyre. Raporti i agjencive të pavarura mbetet instrumenti i vetëm që aktualisht Kuvendi i Republikës e ka për të balancuar pavarësinë me llogaridhënjen, një objektive që ka qenë në vazhdimësi sfidë ndaj agjencive të pavarura.



13. **Analizë e Raportit Vjetor të Operatorit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) për vitin 2019**

Rëndësia e këtij raporti qëndron në informimin e deputetëve dhe opinionit të gjerë me arritjet, ngjarjet, pasqyrën e performancave, operimin e tregut dhe transmetimit, progreset dhe ngecjet e kompanisë. Në këtë raport përfshihen edhe të dhënat rreth projekteve kapitale, politikat e personelit të KOSTT, sidhe sugjerimet dhe propozimet për rritjen e performancave. Analiza e këtij raporti është e ndarë në disa pjesë. Pjesa e parë paraqet analizimin e përmbajtjes dhe kualitetit sa i përket mënyrës dhe gjuhës së përdorur gjatë raportimit. Kjo analizë përmbanë poashtu edhe të dhëna për bazat ligjore si kapitull në vete, në vazhdim analizohet edhe organizimi institucional i kësaj kompanie publike. Më pastaj flitet edhe për kompensimi e bordit dhe shpënzimin e parave publike, si temë goxha me rëndësi, sidhe për donacionet e sponsorisimet e bëra nga ana e kësaj kompanie publike. Në pjesën e fundit flitet për projektet kapitale të planifikuara dhe realizimin e tyre gjatë vitit 2019.



14. **Plani i Rimëkëmbjes së Qeverisë, 10 përqind i Trustit: Pse kjo masë funksionon?**

Në këtë punim reflektohet ana pozitive dhe arsyeshmëria se pse pas së gjithash kjo masë mund të funksionojë dhe të arrihet efekti i saj në rimëkëmbjen ekonomike. Edhe pse kjo masë ka tërhequr vëmendjen e diskursit publik rreth mundësisë së tërheqjen së 10 përqind të kursimeve të tyre, qytetarët ende nuk do të mund të përfitojnë nga kjo masë pa u bërë ndryshimet e nevojshme ligjore.

15. Ligji për barazinë gjinore në Kosovë: Analiza e përmbajtjes, vlerësimi i zbatimit dhe hapat e ardhshëm

Kjo analizë e mbështetur në qasjen e barazisë përmbajtësore synon të jap një pasqyrë të përmbushjes së obligimeve shtetërore të mishëruara në Ligjin për Barazi Gjinore (LBGj) për të promovuar, garantuar dhe mbrojtur barazinë gjinore si një ndër parimet themelore të shtetit kosovar. Analiza fillimisht jep një historik të shkurtër të situatës së grave në Kosovë dhe zhvillimeve legjislative në këtë aspekt. Më pas ajo është e ndarë në katër pjesë kryesore sipas kapitujve të LBGj-së: dispozitat e përgjithshme, mekanizmat institucionalë për barazi gjinore, mbrojtja dhe trajtimi i barabartë në bazë të përkatësisë gjinore në marrëdhëniet e punës, trajtimi i barabartë dhe mbrojtja nga diskriminimi në baza gjinore në fushën e arsimit, sanksionet dhe dispozitat përfundimtare. Secili kapitull analizohet veç e veç në kontekst të barazisë përmbajtësore, përmbajtjes tekstuale dhe zbatimit. Në fund analiza përcjellet me dy propozime rekomanduese lidhur me (mos)zbatimin e LBGj-së.

16. Analizë e Raportit Vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për vitin 2019


Kjo analizë vlerëson nivelin e plotësimit të kërkesave nga Manuali për Raportim të Agjencive dhe Institucioneve të pavarura nga ana e AKP, vlerëson në përgjithësi kualitetin e raportimit, si dhe liston rekomandimet për Komisionin Parlamentar për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike.

17. Analizë e Rregullës për Integritetin dhe Transparencën e Tregut të Energjisë me Shumicë

Kjo analizë me komente është pjesë e programit të Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) për zhvillimin e qëndrueshëm dhe programit të qeverisjes demokratike. INDEP ka analizuar Rregullën e vendosur në konsultim publik nga ana e Zyrës së Rregullatorit për Energji duke u ndjekur nga parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së interesit publik. Komentet janë të ndara në dy pjesë kryesore: komente të përgjithshme dhe komente specifike. Në pjesën e komenteve të përgjithshme, ne kemi bërë një vlerësim të përgjithshëm mbi nismën si të tillë, qasjen e përgjithshme dhe rekomandimet e përgjithshme që i kemi rreth kësaj Rregulle. Në pjesën e komenteve specifike, ne kemi identifikuar dhe shpjeguar nene të caktuara të Rregullës për të cilat kemi vërejtje.


18. **Analizë e Raportit Vjetor të ZRRE-së për vitin 2019**

Kjo analizë e INDEP është organizuar në atë mënyrë që të pasqyrojë strukturën e raportit të ZRRE dhe ndjek një logjikë që të shkohet drejtëpërdrejtë në gjetje dhe pyetje të cilat mund t'i kontribuojnë diskutimit në Komision. Kjo analizë është hartuar në kuadër të projektit që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED). Të gjeturat, qëndrimet dhe rekomandimet e këtij raporti nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e NED.



19. **Analizë e Raportit Vjetor të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës për vitin 2019**

INDEP ka analizuar raportin vjetor të rradhës të Autoritetit Kosovar të Konkurrencës. Gjatë analizës ne kemi vërejtur se raporti është shkruajtur me një gjuhë të përgjithshme dhe ka mjaft elemente të cilat nuk janë raportuar në cilësinë më të lartë. Me hartimin e këtij raporti, AKK ka përmbushur një obligim ligjor për llogaridhënie megjithatë, raporti ka mangësi serioze të cilat do të duhej të plotësoheshin.



20. **Buletini me temë 'Rimëkëmbjen ekonomike'.**

Qëllimi kryesor i këtij buletini është që t'ju ofrojë informata të përmbledhura hisedarëve kryesorë, qytetarëve dhe publikut të gjerë në lidhje me statusin e zbatimit të masave të rimëkë. Ky buletin është pjesë e projektit "Barometri i Rimëkëmbjes – për transparencë dhe llogaridhënie mbjes, të dhënat rreth synimeve dhe pritjeve të Pakos së Rimëkëmbjes si dhe përfituesve kryesorë të këtyre masave.

Punëtoritë / Tryezat

INDEP e konsideron punën me akterë relevante si të domosdoshme për të parë nevojat direkte të qytetarëve dhe akterëve vendimmarrës dhe për të identifikuar saktësisht hapësirat për intervenim. Për këtë arsye, INDEP për vit planifikon punëtori të ndryshme bazuar në portfolion e projekteve, përmes së cilave kryen misionin e vet – ndërtues i sinergjive, avokues për ndryshim dhe partner konstruktiv. Më poshtë janë të listuara disa nga punëtoritë dhe tryezat më të rëndësishme të mbajtura në periudhën janar – dhjetor 2020.

‘Angazhimi për ndryshim – Roli i shoqërisë civile dhe mediave në formësimin e ligjeve dhe iniciativave të Kuvendi’

Punëtorja e parë në serinë prej tri të tilla me titull “Angazhimi për ndryshim – Roli i shoqërisë civile dhe mediave në formësimin e ligjeve dhe iniciativave të Kuvendit” ka mbledhur përfaqësues të organizatave të ndryshme joqeveritare të profilizuara në çështje të llojllojshme të cilët patën rastin të mësojnë më shumë rreth mundësive, mjeteve dhe metodave për kontribut në punën e Kuvendit.



'Punëtorja për ngritjen e kapaciteteve të OShC-ve në Kosovë'

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) në bashkëpunim me Balkan Green Foundation (BGF) në kuadër të projekti 'Empower – Engage – Build Ownership' që këto dy organizata kanë bashkë- implementuar ka mbajtur punëtorinë/trajnimin për ndërtim të kapaciteteve (CBT) që i është dedikuar përfituesve të përzgjedhur në kuadër të Thirrjes së 3-të të Propozimeve për Skemën e Grantëve të Vogla dhe të Mesme. Ky trajnim në përmbajtje pati një përmbledhje rreth menaxhimit të ciklit të projektit, raportimit narrativ, si dhe udhëzimeve për zbatimin e projektit, pasuar nga udhëzimet financiare. Trajnimi është mbajtur nga anëtarët e ekipeve të INDEP dhe BGF.



‘Punëtorja 2 “Angazhimi për ndryshim – Roli i shoqërisë civile dhe mediave në formësimin e ligjeve dhe iniciativave të Kuvendit”’

Në tryezën e tretë me radhë të vitit 2020 INDEP ka mbajtur puëtorinë “Angazhimi për ndryshim – Roli i shoqërisë civile dhe mediave në formësimin e ligjeve dhe iniciativave të Kuvendit” e cila është mbështetur nga National Endowment for Democracy (NED), në kuadër të projektit “Kuvend i fuqizuar për politika dhe ligjvënie efektive, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme”. Në këtë punëtori INDEP mbledhi përfaqësues të organizatave të ndryshme joqeveritare të profilizuara në çështje të llojllojshme të cilët patën rastin të mësojnë më shumë rreth mundësive, mjeteve dhe metodave për kontribut në punën e Kuvendit. Punëtorja u nda në dy pjesë, në pjesën e parë ligjëruan: Armend Ademaj, Udhëheqës i Njesisë Administrative të Komisionit parlamentar për Ekonomi, Punësim, Tregti, Industri, Ndërmarrësi dhe Investime Strategjike dhe Dardan Abazi, Hulumtues i lartë në INDEP i cili shpalosi prezantimin “Nevoja dhe rëndësia e angazhimit të organizatave të shoqërisë civile në legjislaturën e re”, foli për instrumentet kryesore të pjesëmarrjes së shoqërisë civile në punën e Kuvendit dhe mekanizmat në dispozicion për të kontribuar në proceset legjislative. Ndërsa në pjesën e dytë u realizua edhe një ushtrim duke analizuar Ligjin Nr. 04/L-176 për Turizmin dhe duke përdorur metodat e ligjëruara në punëtori.



Konferenca mbi punimin “Ligji për barazinë gjinore në Kosovë: Analiza e përmbajtjes, vlerësimi i zbatimit dhe hapat e ardhshëm”

Në kuadër të projektit “Gratë menaxhere në sektorin publik – lehtësimi i transformimit nga qasja kuantitative në atë kualitative” të mbështetur nga Programi Angazhimi për Barazi-E4E, i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar - USAID dhe i implementuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim - ATRC, INDEP ka realizuar konferencën në të cilën ka publikuar punimin mbi kornizën ligjore për barazinë gjinore në Kosovë. Në këtë tryezë të mbajtur në formatin online ishin të pranishme znj. Edi Gusia, kryeshefe e Agjencisë për Barazi Gjinore (ABGJ) dhe znj. Gresë Rrahmani, eksperte e çështjeve gjinore. Znj. Gusia foli për rëndësinë e harmonizimit të ligjeve të tjera horizontale me Ligji Nr. 05/L-020 Për Barazi Gjinore. Ndërsa, znj. Rrahmani specifikoi që Ligji për Barazi Gjinore nuk reflektohet në ligjet e tjera dhe shtroi nevojën që të diskutohet mundësia që dispozitat e Ligjit për Barazi Gjinore të shkrihen në ligje të tjera në mënyrë obligative.



'Panel diskutimi mbi temën "Roli i Kuvendit në Ushtrimin e Funkcionit Mbikëqyrës dhe Bashkëpunimi me Shoqërinë Civile"'

INDEP në kuadër të projektit "Kuvend i fuqizuar për politika dhe ligjvënje efektive, gjithëpërfshirëse dhe të përgjegjshme" mbështetur nga National Endowment for Democracy (NED) ka mbajtur panelin e diskutimit me temë "Roli i Kuvendit në Ushtrimin e Funkcionit Mbikëqyrës dhe Bashkëpunimi me Shoqërinë Civile" me të ftuarit znj. Shqipe Krasniqi, Zyrtare e Lartë për Planifikim dhe Koordinim Strategjik pranë Kuvendit të Kosovës. Në këtë panel znj. Krasniqi foli për historikun e bashkëpunimit mes Kuvendit dhe organizatave të shoqërisë civile, fillet e diskutimeve rreth hapjes së Kuvendit ndaj OJQ-ve, krijimit të databazës së OJQ-ve nga Kuvendi, formimit të Forumit për Transparencë Parlamentare, bashkëpunimit të deritanishëm me OJQ-të, etj. Z. Abazi drejtoi këtë diskutim si dhe elaboroi rreth bashkëpunimit të INDEP me Kuvendin që prej vitit 2012 dhe sfidat e bashkëpunimit.



'7 Punëtori me përfaqësues të shoqërisë civile dhe qytetarë për aktivizmin mjedisor'

INDEP në kuadër të projektit 'Qytetarë të informuar, monitorim i pavarur dhe koordinim ndër-institucional për politika mjedisore të bazuara në të dhëna në Kosovë' ka mbajtur 7 punëtori me përfaqësues të shoqërisë civile rreth nxitjes së aktivizmit për identifikimin dhe adresimin e problemeve mjedisore në nivel lokal në 7 komuna kryesore të Kosovës – Mitrovicë, Prishtinë, Ferizaj, Pejë, Gjakovë, Prizren dhe Gjiilan. Punëtoritë kanë diskutuar rreth problemeve të ndryshme mjedisore të këtyre rajoneve. Diskutimet kanë vazhduar me elaborimin e zgjidhjeve të këtyre problemeve, si dhe mënyrave specifike në nivel personal me anë të së cilave individualisht mund të kontribuohet në krijimin e një mjedisi sa më të qëndrueshëm.



Tryeza virtuale “Roli i ZRrE-së në mbrojtjen e konsumatorëve në fushën e energjisë”

Në kuadër të projektit “Monitorimi i kuadrit ligjor dhe institucional për mbrojtjen e konsumatorit në sektorët zhvillimor”, financuar nga fondet e Bashkimit Europian, menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë dhe implementuar nga Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP). Tryeza u moderua nga z. Dardan Abazi, Hulumtues i Lartë dhe Drejtor i Programit në INDEP dhe në të ka marrë pjesë, z. Gani Buçaj, Kryesues i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve tek (ZRrE). Z. Abazi e hapi tryezën me një përmbledhje të punës që INDEP po bën për rritjen e vetëdijës për të drejtat e konsumatorëve dhe monitorimit ligjor dhe institucional që përfshihet në aktivitetet e këtij projekti. Ndërsa, z. Buçaj foli për aktivitetet që Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE kryen, për kompetencat që i ka ZRrE-ja në fushën e energjisë, llojet e ankesave që i trajtojnë, shpjegoi procedurën se si trajtohen ankesat, afatet ligjore për trajtimin e ankesave dhe çështje tjera.



‘Mbrojtja e Konsumatorëve: Korniza Ligjore dhe Institucionale nga Perspektiva e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit’

Tryeza “Mbrojtja e Konsumatorëve: Korniza Ligjore dhe Institucionale nga Perspektiva e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit” ka pasur panelistë z. Nijazi Shala, Udhëheqës i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK) në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe z. Plator Gërdovci, Zyrtar i Lartë në DMK. Z. Shala foli për kompetencat ligjore dhe institucionale që Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit posedon për sfidat që i hasin në punën e tyre të përditshme, etj. Ndërsa, z. Gërdovci sqaroi procedurat se si pranohen ankesat te ky department, çka parasheh ligji saktësisht si kompetencë e DMK-së, të drejtat e konsumatorëve që parashihen me ligj, asistencën që e ofron DMK-ja, llojet e ankesave që i trajtojnë, afatet ligjore për trajtimin e ankesave dhe çështje tjera.



Tryeza “Marrëveshja e Gjelbër për Ballkanin dhe Plani Kombëtar për Energji dhe Klimë”

Tryeza ka pasur panelistë z. Luan Morina, Udhëheqës i Departamentit të Energjisë në MEA dhe z. Fisnik Osmanin, Këshilltar i Kryeministrit të Kosovës. Për shkak të pandemisë COVID-19, tryeza është mbajtur pa praninë e audiencës dhe është transmetuar virtualisht në faqen e INDEP-it në Facebook. Tryeza ka trajtuar draftimin e Planin Kombëtar të Kosovës për Energji dhe Klimë dhe bashlëndimin e këtij plani me pikat e Marrëveshjes së Gjelbër për Ballkanin. Tutje në këtë tryezë u diskutua edhe mbi Strategjinë e re të Kosovës në fushën e Energjisë dhe arritjen e qeave për burimet solare dhe ato hidrike duke iu përshtatur kriterëve të dala nga Samiti i Sofjes. Kjo tryezë u implementua në kuadër të projektit "Promovimi i Eficiencës së Energjisë dhe Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë në Kosovë", financuar nga GIZ Kosova, në emër të Qeverisë Gjermane.



Me panelistin Trim Tërnavë, Ekspert i Energjisë së Ripërtëritshme, edhe kjo tryezë u transmetua virtualisht në faqen e INDEP dhe u mbajt pa praninë e publikut, për shkak të masave për parandalimin e infektimit me COVID-19, të vendosura nga Qeveria. Në këtë tryezë u diskutuan dhe elaboruan zhvillimet në fushën e energjisë me theks energjinë solare. Tryeza u implementua në kuadër të projektit “Promovimi i Eficiencës së Energjisë dhe Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë në Kosovë” i mbështetur nga Qeveria Gjermane përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti i Kosovës për Eficiencë të Energjisë.



Bashkëpunimi Rajonal

Gjatë vitit 2020, INDEP ka marrë pjesë në 8 Konferenca Ndërkombëtare. Mes tyre, janë të renditura disa si më poshtë:

- *INDEP pjesë e Forumit Botëror për Organet Këshilluese të OZHQ-ve në Bogota të Kolumbisë*

Në Bogota është mbajtur Forumi Botëror për Organet Këshilluese Kombëtare të OZHQ-ve i cili ka mbledhur një numër të konsiderueshëm pjesëmarrësish, mes tyre edhe INDEP. Takimi fillestar u përqendrua në të kuptuarit se si po ndodh progresi me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Kombeve të Bashkuara në të gjithë botën, kush i monitoron ato në vendet respektive, dhe kush i këshillon liderët politikë për zbatimin e tyre.

Rrjeti u krijua në shtatorin e kaluar në Samitin për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara në New York. Takimi në fjalë krijoi partneritete të para midis vendeve për projekte në energji të ripërtëritshme ose për të ekzaminuar sesi qytetet dhe qeveritë lokale mund të përpilojnë plane të qëndrueshme. Pikë tjetër që u adresua ishte se si vendet individuale mund të kenë politikën e tyre për qëndrueshmëri të shqyrtuar në mënyrë të pavarur, për shembull përmes proceseve të rishikimit nga kolegët.



- *INDEP pjesë e edicionit 2020 të EPG që diskutoi tranzicionin e sektorit të energjisë nga ai konvencional në të gjelbër*

Dora Musa, hulumtuese në INDEP mori pjesë në edicionin e vitit 2020 të shkollës së EPG-së me temë “Transformimi i mençur i sektorit të energjisë “. Për shkak të kushteve të krijuara nga pandemia, shkolla u mbajt virtualisht prej 23 deri 25 korrik, ku do të ketë ligjërata të shumta nga ekspertë të fushës në nivel botëror të cilët do të trajtojnë çështjet kyçe të tranzicionit të energjisë dhe atë se si do të qëndrojë sektori i energjisë pas efekteve të COVID-19. Dora ndau me pjesëmarrësit tjerë punën dhe angazhimin e INDEP-it në sektorin e energjisë nëpërmjet programit të Zhvillimit të Qëndrueshëm, krahas shpalosjes së situatës së këtij sektori në Kosovë.

Në këtë edicion morën pjesë gjithsej 17 profesionistë të rinjë dhe studentë të energjisë nga 14 nacionalitete të ndryshme.

2020 EPG Summer School Participants



Georgian Florentin Albu
Romania



Alina Arsani
Romania



Ghina Daher
Lebanon, Turkey



Eassam Elnagar
Egypt, Belgium



Erençan Eren
Turkey



Ismayıl Fataliyev
Azerbaijan



Elion Gërguri
Kosovo



Jakub Guzikowski
Poland



Constantin Lindenmeyer
Germany



Laura Moșoiu
Romania



Dora Musa
Kosovo



Gabriel Nenov
Bulgaria



Niraj Pandey
Nepal



Seeba Salifu
Ghana, Turkey



Juan Daniel Sidauruk
Indonesia




Austin Tahiliani
Canada



Velin Valkov
Bulgaria

Average age
~ 28 years



EPG
ENERGY POLICY GROUP
SUMMER SCHOOL 2020

- *INDEP pjesë e Progressive Leadership Program 2020*

INDEP ishte pjesëmarrës edhe në Programin e Liderimit Progresiv, edicioni i vitit 2020 me temë “Roli i Liderëve të

Rinj Politikë në Tranzicionin e Energjisë, Ndryshimet Klimatike dhe Qëndrueshmërinë Sociale”. Ky Seminar u mbajt në Beograd të Serbisë prej 24 deri 27 shtator dhe u organizua nga Friedrich-Ebert-Stiftung. Qëllimi i këtij seminary është paraqitja e ndryshimeve klimatike dhe tranzicionit energjetik të kornizës së politikave globale dhe rajonale, për ti prezantuar liderët e rinjë me faktet kryesore dhe instrumentet e politikave të zhvilluara në nivel global, të BE-së dhe gjithashtu edhe të Komunitetit të Energjisë. Seminarin përfshiu gjithashtu edhe shembuj të zbatimit të tyre në kontekstin rajonal. Dora Musa nga INDEP ka folur për punën që bën INDEP në Kosovë në këtë drejtim por gjithashtu edhe për gjendjen e Kosovës sa i përket tranzicionit të energjisë dhe politikave publike kundër ndryshimeve publike.



INDEP në Medie

Si secilin vit tjetër, edhe këtë vit INDEP ishte prezent në medie përmes prononcimeve të ndryshme. Me fokus në fushën e energjisë dhe qeverisje demokratike, INDEP ishte pjesë e medieve më shumë se 30 herë. INDEP konsideron që mediet luajnë rol vendimtar në informimin e drejtë të publikur, prandaj përpiqet që të pranojë kërkesat për prononcime dhe është gjithmonë i paanshmën në paraqitje mediatike.

Donatorët

Puna e INDEP është e pamundur pa mbështjetjen e donatorëve tanë. INDEP i falënderon përzemërsisht të gjithë donatorët që kanë mbështetur portfolion e INDEP gjatë vitit 2020, me theks Rockefeller Brothers Fund (RBF), Zyrën e Bashkimit Europian në Kosovë, si dhe GIZ-in gjerman – Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit. Më poshtë gjeni listën e plotë të donatorëve të INDEP.

